



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:236393

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05417448

P.nr.1238/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Refki Piraj, me bashkëpunëtoren profesionale Arbnije Gashi, në çështjen penale ndaj të akuzuarve T.B., nga Suhareka, rruga ‘L.....’ nr..... , për shkak të veprës penale, Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 371 par.2 lidhur me par.1të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK) dhe të akuzuarit S.K., nga Prizreni, rruga ‘.....’nr....., për shkak të veprës penale, Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 371 par.1të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.1826-15/23 të datës 22.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në seancë publike, në praninë e prokurorit të shtetit Labinot Jetishi, të akuzuarit T.B., dhe S.K., me datë 29.01.2024 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa më datë 01.03.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. **T.B.**, nga i ati e ëma, i lindur me datë, nga Suhareka, rruga ‘.....’ nr....., ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, i ati i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal
2. **S.K.**, nga i atie ëma, i lindur me datë, nga Prizreni, rruga ‘.....’ nr....., ka të kryer fakultetin, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, i ati i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal

JANË FAJTOR

I akuzuari, T.B.,

I. Se me datë 31.07.2023, rreth orës 01.50min, pas mesnate, ne fshatin Korish, Komuna e Prizrenit, i pandehuri duke e drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit me 0.84 % shkakton aksident trafik, në atë mënyrë që derisa po lëvizte me automjetin e markës “.....” me targa regj., ngjyrë e gjelbër, me të arritur te ura, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes për atë pjesë të rrugës humb kontrollin mbi automjetin dhe kalon ne shiritin e majtë ku e godet automjetin e tipit “.....”, ngjyrë e kaltër, me targa, të cilin e drejtonte i dëmtuari S.K., kur përveç dëmeve materiale në dy automjete, lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari

S.K., gjendje kjo e konstatuara sipas akt ekspertizës mjeko-ligjore të Dr. V.K., të dt.18.10.2023.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 371 par.2 lidhur me par.1të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës të KPRK-së.

I akuzuari, S.K.,

II. Se me datë 31.07.2023, rreth orës 01.50min, pas mesnate, ne fshatin Korishë Komuna e Prizrenit, i pandehuri duke e drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit me 1.18 %o shkakton aksident trafiku, në atë mënyrë që derisa po lëvizte me automjetin e markës “.....”, ngjyrë e kaltër, me targa, me të arritur te ura, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, humb kontrollin mbi automjetin duke e goditur automjetin e markës “.....”ga regj....., ngjyrë e gjelbër, të cilin e drejtonte i dëmtuari T.B., me ç’rast te njëjtit i shkakton dëme materiale ne automjet

Me këto veprime ka kryer veprën penale, Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 371 par. 1të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, nenit 242 dhe nenit 364 të KPPRK-së nr. 08/L-032 (KPP), u shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit T.B., në shumë prej pesëqind (500) euro të cilat do ta paguaj në llogarinë e kësaj gjykate nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e nëse dënimi me të holla nuk mund të paguhet nga ana e të akuzuarit në afatin ligjore i njëjti do te zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur 20 euro për 1 dite burgim gjegjësisht 25 ditë burgim.

Të akuzuarit S.K., në shumë prej treqind (300) euro, të cilat do ta paguaj në llogarinë e kësaj gjykate nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e nëse dënimi me të holla nuk mund të paguhet nga ana e të akuzuarit në afatin ligjore i njëjti do te zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur 20 euro për 1 ditë burgim gjegjësisht 15 ditë burgim.

I dëmtuari P.K., me banim në Pejë, Rr.”.....i” p.nr, Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohen të pandehurit t’i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen në bazë të llogarisë së gjykatës, në mënyrë solidare në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të paguajnë shumën prej 20.00 euro, ndërsa secili veç e veç, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20.00 euro dhe në zbatim të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të krimit të akuzuarve i caktohet taksa secili në lartësi prej 20.00 euro, të cilat janë të obliguar ta paguajnë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën, PP/II.nr.1826-15/23 të datës 22.11.2023, ndaj të akuzuarve T.B., nga Suhareka, rruga ‘.....’ nr..... , për shkak të veprës penale, Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 371 par.2 lidhur me par.1të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK) dhe të akuzuarit S.K., nga Prizreni, rruga ‘..... nr..... , për shkak të veprës penale, Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 371 par.1të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës (KPRK).

Pas pranimit të shkresave të lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues me datën 29.01.2024 ka caktuar seancën gjyqësore, në të cilën seancë të akuzuarit T.B., dhe S.K., pas udhëzimeve të dhëna nga gjykata, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, vullnetarisht kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila u vihet në barrë.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve dhe kërkon nga gjykata që të njëjtit të dënohen sipas ligjit duke marr parasysh gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

I akuzuari T.B., ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale në tërësi si në aktakuzë.

I akuzuari S.K., ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale në tërësi si në aktakuzë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka miratuar pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 242 lidhur me 241 të KPPRK-së. Me rastin e pranimit të fajësisë, gjykata vërtetoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet dhe provat materiale që gjendjen në shkresat e lëndës si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 244 të KPPRK-së, për pushimin e procedurës penale, përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga të akuzuarit konform nenit 241 dhe 242 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtim gjyqësor nga pranimi i fajësisë së të akuzuarve dhe provave materiale në shkresat e lëndës si, procesverbalin mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit-dëmtuarit S.K., të dhënë në Prokurorinë Themelore në Prizren, me datë 03.11.2023, nën prezencën e mbrojtësit av. S.G., , procesverbalin mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit T.B., të dhënë në Prokurorinë Themelore në Prizren, me datë 07.11.023 nën prezencën e mbrojtësit E.H., e angazhuar sipas detyrës zyrtare, akt ekspertimi mjeko ligjor me nr. të referencës 05/2023 i datës 18.10.2023 për të dëmtuarin S.K., punuar nga Dr.V.K., , eksperte mjeko-ligjor, foto-albumi me fotografitë nga vendi i ngjarjes, rezultatit nga alkool-testi, i datës 31.07.2023 si dhe shkresat tjera të lëndës, nga të cilat ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj, kjo gjykatë duke u bazuar në ato që u thanë më lartë, ka vërtetuar gjendjen faktike si në aktakuzë dhe me këtë rast, gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor duke u shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Për të gjykuarin T.B., gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, rrethana të tjera lehtësuese mori parasysh, keqardhjen e shfaqur nga i akuzuari, si dhe gjendjen e dobët ekonomike, ndërsa si rrethana rënduese ndaj të njëjtit ka gjetur shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të tij në kryerjen e veprës penale, se i njëjti me veprimet e tija, duke përdorur alkool, e sjell vetën në gjendje, në të cilën nuk ka mundur ti kontrolloi veprimet e tij, dhe si pasojë e tyre ka shkaktuar veprën penale. Për të gjykuarin L.S., gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, rrethana të tjera lehtësuese mori parasysh, keqardhjen e shfaqur nga të akuzuarit, ndërsa si rrethana rënduese ka gjetur se i njëjti me veprimet e tija, duke përdorur alkool, e sjell vetën në gjendje, në të cilën nuk ka mundur ti kontrolloi veprimet e tij, dhe si pasojë e tyre ka shkaktuar veprën penale. Andaj gjykata ka vlerësuar se dënimet janë të drejta, dhe në harmoni me peshën e veprës penale, gjendjen ekonomike dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarve. Gjyqtari i vetëm gjykues, konsideron se me këto dënime mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Në fund, gjykata ka marrë parasysh edhe sanksionet tjera penale të përcaktuara me KPRK, mirëpo ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, në mënyrë të plotë dhe të drejtë mund të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi pagesën e taksës në emër të Programit për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin për kërkesat pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 457 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.1238/2023 të datës 06.03.2024

Gjyqtari
Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.